

Burimet: deklarata R.M, FDH-30768; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Blerim (Haxhi) Berisha

(14.02.1983, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, nxënës)

Në datën **8.10.1998**, diku nga ora 11:00, Blerimi u nis me babanë Haxhiun, vëllain Kujtimin dhe komshiun e parë Pjetrin, për të ngarkuar dru për djeie në një pyll përkaj fshatit Prush/Pruš. U nisën me dy qerre me kuajt samari. Pasi e kryen punën, diku nga ora 17:00, vendosën që të ktheheshin në shtëpi. Blerimi e drejtonte qerren e dytë me radhë, ndërkaq Haxhiu ishte ulur prapa mbi drurët. Në afërsi të fshatit **Prush/Pruš** dhe jo shumë larg të kufirit me Shqipërinë, kur qerrja e parë me Pjetrin dhe Kujtimin kishte avancuar larg prej asaj me Blerimin dhe Haxhiun, pjesëtarët e forcave serbe hapen zjarr mbi qerren e dytë. Të trembur nga të shtënat, kuajt e Blerimit nisën të vraponin shpejt, duke e rrëzuar Haxhiun në tokë, ndërkaq Blerimi qëndroi në ulësen e parë. Haxhiu u fsheh në pyll. Kur ia doli më në fund që të shkoste në shtëpi, i thanë se qerrja me kuajt kishte arritur, por pa Blerimin. Ditën tjetër, herët në mëngjes, nga ora 6:00, Haxhiu me të vëllain Jetonin shkuan në vendin ku Haxhiu u detyrua që të ndahej nga i biri, një ditë më parë. Atje e gjetën një njollë të madhe gjaku, por nuk kishte kurrfarë gjurmësh tjera të Blerimit. Pastaj, shkuan në morgun e Gjakovës/Đakovica dhe atje e gjetën trupin e Blerimit të vrarë. Familjarët e kanë varrosur atë në varrezat e qytetit në Gjakovë/Đakovica, më 10.10.1998.

Burimi: deklarata S.B, FDH-34223.

Ilir (Mazllom) Soba

(28.04.1971, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, student, pjesëtar i UÇK-së)

Iliri ka qenë student i vitit të tretë të Fakultetit Elektroteknik në Prishtinë/Priština. Në muajin maj të vitit 1998, i ka ndërprerë studimet dhe u lajmërua në shtabin e UÇK-së në Glogjan/Glodane. Iliri ka rënë gjatë betejës me forcat serbe në fshatin **Kralan/Kraljane**, më **18.10.1998**. U var-

ros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gjakovë/Đakovica.

Burimet: H. Hasani, Dëshmorët..., FDH-25596; J. Martinsen, Regjistri..., FDH-26092; I. Koci, Genocidi..., 499.

Xheladini (Qazim) Dauti

(23.04.1955, shqiptar nga Golaj [Shqipëri], minator, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xheladini ka aderuar në UÇK gjatë vitit 1998. Ishte në përcjellje të ushtarëve të UÇK-së që i bartnin armatimet në Kosovë. Pjesëtarë të UÇK-së shpesh e kalonin natën në shtëpinë e tij. Në datën **21.10.1998**, rreth orës 21:00, Xheladini ka dal nga shtëpia dhe ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Ditën e nesërme, *Zëri i Amerikës* ka bërë të ditur se Xheladini Dauti ka pësuar në rrethinën e fshatit **Goden**. Pjesëtarët e misionit të OSBE-së e kanë bartur trupin në morgun e Gjakovës/Đakovica. I afërmi Bashkim Xhuxha e ka identifikuar trupin e Xheladinit. Me ndërmjetësimin e misionit të OSBE-së, trupi i Xheladinit i është dorëzuar familjes më 25.10.1998 në vendkalimin *Qafa e Prushit*. Xheladinit e kanë varrosur në fshatin e tij të Golajt.

Burimet: deklarata G.D, FDH-40648; J. Osmani, *Krimet...*, II, 467.

Ramiz (Hamëz) Sylmetaj

(8.11.1970, shqiptar nga Gërçina/Grçina, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, dy fëmijë)

Leonora (Gani) Sylmetaj

(13.05.1985, shqiptare nga Gërçina/Grçina, komuna e Gjakovës/Đakovica, nxënëse)

Muharrem (Ramiz) Sylmetaj

(20.06.1993, shqiptar nga Gërçina/Grçina, komuna e Gjakovës/Đakovica)

Mazllum (Ramiz) Sylmetaj

(5.11.1996, shqiptar nga Gërçina/Grçina, komuna e Gjakovës/Đakovica)

Ramizi me bashkëshorten Ajshen dhe djemtë Muharremin dhe Mazllumin jetonin në Gërçinë/Grçina, një fshat ky në brezin kufitar me Shqipërinë. Me ta jetonte edhe vëllai i Ramizit, Fadili, me familjen e vet, si dhe bashkëshortja e vëllait të tretë të Ramizit, Ganiut, me vajzën Le-